



ORMIDOL

Atenolol 100 mg, tabletë e veshur me film

- 1. Çfarë është ORMIDOL dhe për çfarë përdoret**
- 2. Çfarë duhet të dini përpara se të merrni ORMIDOL**
- 3. Si merret ORMIDOL**
- 4. Efekte anësore të mundshme**
- 5. Si ruhet ORMIDOL**
- 6. Përmbajtja e paketimit dhe të dhëna të tjera**

1. Çfarë është ORMIDOL dhe për çfarë përdoret

ORMIDOL përmban principin aktiv atenolol dhe i përket një grupi medikamentesh të quajtura beta-blokues.

ORMIDOL përdoret për:

- Trajtimin e tensionit të lartë (hipertension)
- Trajtimin e çrregullimeve të ritmit të zemrës (arritmi)
- Ndhmon në parandalimin e dhimbjes së gjoksit (anginë)
- Ndhmon zemrën në trajtimin e hershëm pas atakut kardiak (infarkt të zemrës), si dhe ofron mbrojtje afatgjatë kundër reinfarkt.

ORMIDOL funksionon duke ulur ritmin e zemrës dhe forcën e kontraktimit kardiak.

2. Çfarë duhet të dini përpara se të merrni ORMIDOL

Mos merrni ORMIDOL në rast se:

- Jeni alergjik (mbindjeshmëri) ndaj atenololit ose ndonjë prej ingredientëve të tjerë të ORMIDOL (Shih seksionin 6)
- Në rast se keni vuajtur ndonjëherë prej këtyre problemeve të zemrës:
 - o Insuficiencë kardiake e pakontrolluar (zakonisht insuficienca kardiake shkakton shkurtrim të frymëshkëmbimit dhe ënjtje të kyçeve të këmbëve).
 - o Bllok kardiak të gradës së dytë ose të tretë (sëmundje e cila mund të trajtohet me hapshënues)
 - o Ritëm kardiak shumë i ngadaltë (bradikardi) ose ritëm kardiak i çrregullt (sindroma e sinusit të sëmurë)
 - o Presion arterial shumë i ulët ose problema me qarkullimin e gjakut

- Në rast se keni një tumor me emrin feokromocitomë i cili nuk është në trajtim. Zakonisht ky tumor ndodhet pranë veshkës dhe mund të shkaktojë rritje të presionit arterial. Në rast se po trajtoheni për feokromocitomë, mjeku juaj, përpara se t'iu japë ORMIDOL, do t'iu japë një medikament tjetër të grupit të alfablokuesëve.
- Ju kanë thënë se keni nivele të larta të acideve në gjak (acidozë metabolike).

Paralajmërime dhe parandalime

Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni ORMIDOL në rast se:

- Keni astmë, gulçime apo probleme të ngjashme me frymëmarrjen, ose në rast se shfaqni reaksione alergjike, për shembull pas pickimeve të insekteve. Në rast se keni pasur astmë ose gulçime, mos e merrni këtë medikament pa u konsultuar më parë me mjekun tuaj.
- Keni një lloj dhimbjeje gjoksi (anginë) që quhet angina Prinzmetal.
- Keni probleme me qarkullimin e gjakut ose insuficiencë kardiake të kontrolluar.
- Keni bllok kardiak të gradës së parë.
- Keni diabet. Medikamenti mund të ndryshojë mënyrën se si ju i përgjigjeni niveleve të ulëta të sheqerit në gjak.
- Ndjeni se zemra ju rreh më shpejt.
- Keni tirotoksikozë (një sëmundje që vjen si pasojë e mbifunksionimit të gjendrës tiroide). Medikamenti mund të fshehtë simptomat e tirotoksikozës.
- Jeni në moshë më të madhe se 65 vjeç.
- Keni problema me veshkat. Mund të keni nevojë për kontrolle gjatë trajtimit.
- Do t'iu nënshtroheni një ndërhyrjeje kirurgjikale.
- Jeni shtatzënë, planifikoni shtatzëni ose ushqeni foshnjën tuaj me qumësht gjiri.

Në rast se nuk jeni i sigurt nëse një nga situatat e mësipërme aplikohet apo jo te ju, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni ORMIDOL.

Medikamentet e tjera dhe ORMIDOL

Tregojini mjekut ose farmacistit tuaj në rast se jeni duke marrë ose keni marrë medikamente të tjera gjatë kësaj periudhe, përfshirë edhe ato të cilat merren pa recetë. Kjo është e vlefshme edhe në rastin e medikamenteve bimore dhe atyre homeopatike.

ORMIDOL mund të ndikojë në mënyrën e funksionimit të medikamenteve të tjera, ndërkohë që edhe këto medikamente mund të kenë efekt mbi ORMIDOL.

Tregojini mjekut tuaj në rast se jeni duke marrë një nga këto medikamente:

- Klonidinë (për trajtimin e presionit të lartë të gjakut ose migrenës). Në rast se jeni duke marrë klonidinë dhe ORMIDOL njëkohësisht, mos e ndërprisni klonidinën përveç se në rastin kur këtë e rekomandon mjeku juaj. Në rast se do iu duhet të ndërprisni klonidinën, mjeku juaj do iu japë informacion të rëndësishëm se si ta bëni këtë.
- Verapamil, diltiazem dhe nifedipinë (për trajtimin e presionit të lartë të gjakut ose dhimbjes së gjoksit)
- Disopiramid, kinidinë ose amiodaron (për trajtimin e çrregullimeve të ritmit kardiak)
- Digoksinë (për probleme kardiake)
- Adrenalinë, e njohur edhe me emrin epinefrinë (medikament i cili stimulon zemrën)
- Ibuprofen ose indometacinë (për dhimbje dhe inflamacion)

- Insulinë ose medikamente orale për diabetin.
- Medikamente për trajtimin e kongestionit të hundës ose sinuseve, apo ilaçe të tjera kundër

Ndërhyrje kirurgjikale

Në rast se shtroheni në spital për t'iu nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale, tregojini anestezistit ose stafit mjekësor se jeni duke marrë ORMIDOL. Duhet ta bëni këtë pasi mund të keni ulje të presionit të gjakut (hipotension) në rast se merrni njëkohësisht disa medikamente anestezike të caktuara dhe ORMIDOL.

Shtatzëni dhe ushqyerja me qumësht gjiri

Në rast se jeni shtatzënë, duke ushqyer me gji foshnjën tuaj, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose planifikoni të bëni një fëmijë, atëherë pyesni mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni këtë medikament.

Është shumë e rëndësishme që t'iu tregoni mjekut tuaj se jeni shtatzënë ose planifikoni një shtatzëni. Marrja e tabletave të ORMIDOL gjatë shtatzënisë kërkon një vlerësim të plotë të përfitimeve përkundrejt riskut që mund të sjellë kjo terapi, veçanërisht gjatë trimestrit të parë dhe të dytë të shtatzënisë, duke qenë se ka pasur raste vdekje fetale dhe lindje të parakohshme.

ORMIDOL mund të përdoret në trimestrin e tretë të shtatzënisë për trajtimin e presionit të lartë të gjakut, nën mbikëqyrjen e një mjeku, në rast se përfitimet potenciale tek nëna tejkalojnë riskun për fetusin.

ORMIDOL mund të ekskretohet me qumështin e gjirit. Është e rëndësishme që t'iu tregoni mjekut tuaj në rast se jeni duke i dhënë gji foshnjës suaj

Drejtimi i automjeteve dhe makinerive

Ky medikament ka pak gjasa që të ndikojë në aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin apo për përdorimin e makinerive. Megjithatë, do të ishte mirë të prisnit për të parë se si ndikon ky medikament tek ju përpara se të kryenit këto veprimtari. Në rast se ndjeni marrje mendsh ose i lodhur gjatë marrjes së këtij medikamenti, shmangni drejtimin e automjetit ose përdorimin e makinerive.

ORMIDOL përmban laktozë

ORMIDOL përmban laktozë. Në rast se mjeku juaj iu ka thënë se keni intolerancë ndaj disa lloje sheqernash, konsultohuni me të përpara marrjes së këtij medikamenti.

3. Si merret ORMIDOL

Merreni këtë medikament ashtu siç përshkruhet në këtë fletëpalosje ose duke ndjekur rekomandimet e mjekut ose farmacistit tuaj. Në rast se keni dyshime, pyesni përsëri mjekun ose farmacistin tuaj.

Mjeku juaj do t'iu tregojë se sa tableta duhet të merrni çdo ditë si edhe kohën kur duhet ti merrni.

Të rriturit

Trajtimi i hipertensionit

Doza e zakonshme është një tabletë ORMIDOL 50 mg një herë në ditë. Në rast se është e nevojshme, doza mund të rritet deri në 100 mg në ditë.

Angina (dhimbja e gjoksit)

Doza e zakonshme është 100 mg ORMIDOL një herë në ditë ose 50 mg dy herë në ditë.

Aritmi (ritëm i çrregullt i zemrës)

Doza e zakonshme është 50 deri 100 mg ORMIDOL në ditë.

Të moshuarit (>65 vjeç)

Në rast se jeni mbi 65 vjeç, mjeku juaj mund të vendosë që t'iu japë një dozë më të ulët, sidomos në rast se keni probleme me veshkat.

Persona me probleme në veshka

Në rast se keni probleme serioze renale, mjeku juaj mund të vendosë t'iu japë një dozë më të ulët.

Përdorimi në fëmijë dhe adoleshentë

Tabletat e ORMIDOL nuk duhen përdorur në fëmijë dhe adoleshentë.

Metoda e dhënies

Gëlltiteni të gjithë tabletën me një gotë ujë.
Mundohuni ta merrni medikamentin çdo ditë në të njëjtën orë.

ORMIDOL 100 mg, tabletë e veshur me film

Tableta ka një vijë ndarëse e cila shërben për ta ndarë në doza të barabarta prej 50 mg.

Në rast mbidozimi me ORMIDOL

Në rast se ju keni marrë më shumë tableta Ormidol se sa ato që iu ka përshkruar mjeku juaj, ju duhet të kontaktoni me qendrën shëndetësore më të afërt ose të njoftoni mjekun apo farmacistin tuaj. Merrni me vete ambalazhin ose fletëpalosjen e medikamentit për ti ardhur në ndihmë profesionistëve të shëndetit që të dinë me saktësi medikamentin që keni marrë.

Në rast se keni harruar të merrni ORMIDOL

Në rast se keni harruar të merrni një dozë, merreni sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, në rast se është koha për të marrë dozën e ardhshme, atëherë mos e merrni dozën e harruar. Mos merrni asnjëherë një dozë të dyfishtë për të zëvendësuar dozën e harruar.

Në rast se ndërprisni marrjen e ORMIDOL

Ndërprerja e trajtimit me tableta ORMIDOL mund të çojë në përkeqësime të sëmundjes. Mos e ndërprisni trajtimin pa folur me mjekun tuaj. Ndërprerja e ORMIDOL bëhet gradualisht përgjatë 7-14 ditëve.

Në rast se keni pyetje të tjera mbi përdorimin e medikamentit, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. Efekte anësore të mundshme

Ashtu si të gjitha medikamentet e tjera, edhe ky medikament mund të shkaktojë efekte anësore, pavarësisht se nuk shfaqen tek të gjithë.

Reaksione alergjike

Në rast se keni një reaksion alergjik, shkoni te mjeku menjëherë. Shenjat mund të përfshijnë skuqje të lëkurës (urtikarie) ose ënjtje të fytyrës, buzëve, gjuhës ose fytyrës.

Efekte anësore të mundshme

Të shpeshta (prekin më pak se 1 në 10 persona)

- Ju mund të vëreni se e keni pulsën më të ngadaltë gjatë marrjes së ORMIDOL. Kjo është diçka normale, por nëse është diçka që iu shqetëson flisni me mjekun tuaj.
- Duar dhe këmbë të ftohta
- Diarre
- Të përziëra (nauze)
- Ndjesi lodhjeje

Jo të shpeshta (prekin më pak se 1 në 100 persona)

- Çrregullime të gjumit

Të rralla (prekin më pak se 1 në 1000 persona)

- Bllok kardiak (i cili mund të shkaktojë ritëm anormal, marramendje, lodhje ose të fiktë)
- Sëmundja Raynaud (mpirje dhe spazma në gishta të cilat ndiqen nga ndjesi ngrohtësie dhe dhimbje)
- Ndryshime në humor
- Ankth
- Konfuzion
- Ndryshime në personalitet (psikoza) ose halucinacione
- Dhimbje koke
- Marramendje (veçanërisht gjatë qëndrimit në këmbë)
- Ndjesi shpimi në duar
- Paaftësi për ereksion, impotencë
- Tharje goje
- Tharje e syve
- Çrregullime të shikimit
- Hollim i fijes së flokëve
- Skuqje e lëkurës
- Ulje e numrit të trombociteve në gjak (lëkura juaj mund të nxihet më lehtë)
- Shenja ngjyrë vjollcë në lëkurë
- Ikter (zverdhje e lëkurës ose e pjesës së bardhë të syrit)

Shumë të rralla (prekin më pak se 1 në 10 000 persona)

- Ndryshime në rezultatet e analizave të gjakut

Mjeku juaj mund të kërkojë kampione gjaku herë pas here për të përcaktuar nëse ndryshimet vijnë apo jo nga marrja e ORMIDOL.

Patologji të cilat mund të përkeqësohen:

Në rast se ju vuani nga një prej sëmundjeve në vijim, ato mund të përkeqësohen kur të filloni të merrni këtë medikament. Kjo ndodh rrallë dhe prek më pak se 1 në 1000 persona.

- Psoriazë
- Marrje fryme ose ënjtje e kyçeve të këmbëve (në rast se vuani nga insuficienca kardiake)
- Astmë ose probleme me frymëmarrjen
- Probleme me qarkullimin e gjakut

Raportimi i efekteve anësore

Në rast se shfaqet ndonjë prej efekteve anësore, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Këtu përfshihen edhe efektet të cilat nuk janë të listuara në këtë fletëpalosje. Gjithashtu, ju mund të raportoni efekte anësore drejtpërdrejtë nëpërmjet sistemit kombëtar të raportimi të listuar në Apendiksin V*. Me anë të raportimit të efekteve anësore ju mund të ndihmoni në dhënien e informacionit mbi sigurinë e këtij medikamenti.

5. Si ruhet ORMIDOL

Mbajeni këtë medikament larg fëmijëve.

Mos e ruani në një temperaturë më të lartë se 25°C.

Mos e përdorni këtë medikament pas datës së skadencës të stampuar në paketim. Data e skadencës i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Medikamentet nuk mund të hidhen në tualet apo në plehra. Pyesni farmacistin tuaj se çfarë duhet të bëni me medikamentet që nuk do i përdorni më. Këto masa ndihmojnë në ruajtjen e mjedisit.

6. Përmbajtja e paketimit dhe të dhëna të tjera

Çfarë përmban ORMIDOL

Principi aktiv është atenolol.

ORMIDOL 100 mg, tableta të veshura me film: një tabletë e veshur me film përmban 100 mg atenolol.

Ingredientët e tjerë janë:

Bërthama e tabletës: celulozë mikrokristaline, laktozë monohidrat, povidon; ekstrakt misri; talk; silicium, koloidal, anhidroz; kroskarmelozë; magnezium stearat.

Veshja e tabletës: hipromelozë; talk, dioksid titaniumi (E171); disodium edetat dihidrat; karnauba vax.

Pamja e ORMIDOL dhe përmbajtja e paketimit

ORMIDOL 100 mg tabletë është e bardhë, bikonvekse, e veshur me film dhe me një vijë ndarëse nga njëra anë. Vija ndarëse ka për qëllim ndarjen e tabletës në dy doza të barabarta prej 50 mg.

ORMIDOL 100 mg, tableta të veshura me film: 28 (2x14) tableta në blister PVC/PVDC/Al në kuti.

Mbajtësi i Liçencës së Tregëtimit :

Farmavita d.o.o. Sarajevo

Igmanska 5a

71320 Vogošća, Bosnje dhe Hercegovinë

Prodhuesi:

BELUPO Pharmaceuticals and Cosmetics, Inc.,

Ulica Danica 5

48 000 Koprivnica, Kroaci

Ky fletëudhëzues u aprovua për herë të fundit me:

12/2016